



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIK OF KOSOVA  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Për :Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Jetish Maloku - Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



29.07.2021			
Titulli	Numri i Aktit	Id. Prokur.	
05	47	1406	11

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E  
REKOMANDIMEVE**

të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra  
Kombëtare e Auditimit

[Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve  
në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin  
Prokurorial të Kosovës?]

Nr	Gjetja/titulli	Rekomandimi	Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit/Zyrtari/ët përgjegjës	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Koha/Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	<p>SMIL-i ende nuk ka zbatim të plotë në të gjitha instancat e gjykatave dhe prokurorive. Deri më tani, SMIL-i ka arritur të zbatohet në Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore dhe Prokurorinë e Apelit. Në Gjykatën e Apelit, Gjykatën Supreme, zbatimi i SMIL-it ka filluar në janar të vitit 2021, ndërsa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ende nuk ka filluar përdorimi i SMIL-it. Kjo për shkak që ende nuk ka përfunduar zhvillimi i SMIL-it për këto instanca.</p>	<p>Zbatimi dhe zhvillimi i sistemit SMIL. KGJK-ja dhe KPK-ja të zbatojnë Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor/prokurorial në Kosovë dhe të zbatojnë të gjitha proceset në sistem për trajtimin e lëndës. T'i japin prioritet zhvillimit të sistemit për finalizimin e ndërlidhjes së SMIL-it të Gjykatës dhe Prokurorisë dhe zhvillimin e raporteve të avancuara statistikore në përputhje me treguesit CEPEJ për gjykatat, si dhe raportet bazike dhe të avancuara për prokuroritë;</p>	Projekti TIK/SMIL	<p>Projekti SMIL – faza konsoliduese është në proces të implementimit dhe përfundon në dhjetor 2021. Qëllimi final i SMIL është zbatimi i tij, në të gjitha prokuroritë e Kosovës.</p> <p>SMIL për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit deri më tani ka përfunduar definimi i kërkesave funksionale të sistemit.. Momentalisht sistemi është ende në proces të zhvillimit. Versioni i parë ka përfunduar për lëmin penal, ndërsa është duke u zhvilluar sistemi për lëmin civil. Meqenëse Prokuroritë Themelore dhe Prokuroria e Apelit nuk merren me lëndët civile, ndërsa Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) në fushë veprimin e saj merret edhe me lëndë civile. Pra për here të parë lëmia civile është paraqitur të ZKPSH dhe si rezultat ka qenë e nevojshme definimi i detajuar për menaxhimin e procesit të punës për këtë lëmi.</p>	Nëntor, 2021

				<p>Raporti i parë statistikore është publikuar në SMIL, i cili paraqet lëndët në punë, të zgjidhur dhe të pa zgjidhur si dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve për secilën prokurori/departament/prokuror/lloji i lëndëve ndërsa në fazën e testimil është ende raporti i avancuar.</p> <p><i>Të bashkangjitur gjeni formën (filtrat) e raportit të avancuar.</i></p>	
2	<p>Departamenti i TI-së në KPK për të definuar, dizajnuar proceset e punës dhe ekzekutuar ato, si dhe për të ruajtur integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e aseteve të informacionit, në gusht të vitit 2020 kishte hartuar procedurat standarde të operimit (PSO) të Departamentit të TI-së. Këto PSO ishin miratuar me 4 nëntor të vitit 2020. Mirëpo, disa procese të PSO-ve ende nuk kishin filluar së</p>	<p>Politikat dhe procedurat e TI-së. KPK-ja të zbatojë të gjitha procedurat e përcaktuara të PSO-ve të Departamentit të TI-së. KGJK-ja dhe KPKP-ja të krijojnë mekanizma për monitorimin e zbatimit të politikave si dhe hartojë raporte për nivelin e zbatimit të tyre;</p>	<p>Departamenti i TI</p>	<p>Departamenti i TI, ka përgatitur të gjitha Procedurat e nevojshme për fushën e TI.</p> <p>Këto procedura kanë hyrë në fuqi në muajin nëntor '21 ndërsa auditimi ka filluar pak javë më vonë përkatësisht gjatë fazës së implementimit të kësaj procedure.</p> <p>Tashunë, këto procedura janë zbatuar në tërësi si dhe janë caktuar personat të cilët në baza të rregullta raporton për zbatueshmërinë e tyre.</p>	<p>Ky aktivitet është zbatuar</p>

	<p>zbatuari deri në dhjetor 2020 për shkak se ishte kohë e shkurtë. Sipas zyrtarëve të KPK-së, shkak për vonesat e hartimit, miratimit dhe zbatimit e PSO-ve ishte se deri në fund të vitit 2018KPK-ja kishte përdorur infrastrukturën e TI-së të KGJK-së, deri në ndërtimin e qendrës së të dhënave. Po ashtu, edhe aktivitetet e vazhdueshme në projektin SMIL, kishin ndikuar në vonesën e hartimit të dokumenteve të nevojshme për Departamentin e TI-së dhe monitorimin e zbatimit të tyre.</p>				
3	<p>Në KPK, shpërndarja e rastësishme e lëndëve te prokurorët në mënyrë automatike në SMIL është zhvilluar në instancën e Prokurorive Themelore, mirëpo, në Prokurorinë Themelore (PTh) në Prishtinë dhe Prokurorinë Speciale (PS), caktimi i prokurorit bëhet në mënyrë</p>	<p>Shpërndarja automatike e lëndëve në SMIL. Ngarkesa me lëndë. KPK-ja në SMIL, të zhvillojë dhe zbatojë funksionin që në mënyrë automatike të përcaktohet ngarkesa fillestare e lëndëve për prokurorët dhe të harmonizohet rregullorja për administrimin dhe shpërndarjen e peshës së lëndëve në Prokurorinë e</p>	KPK	<p>Është në proces të përgatitjes së Draft Rregulloren për menaxhimin e procesit të punës në sistemin prokurorial përmes SMIL. Komisioni për Çështje Normative ka organizuar punëtori me stafin e prokurorive si dhe ka bërë prezantimin e Draftit të parë të kësaj rregullore. Është në fazën e komenteve dhe deri në muajin Dhjetor '21 pritet të aprovohet nga KPK.</p>	Dhjetor, 2021

	<p>manuale. Mos zbatimi i shpërndarjes automatike të lëndëve në këto prokurori, ka ndodhur si rezultat i formimit të Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion në PTh Prishtinë dhe sipas udhëheqësit të departamentit të TI-së në KPK, nuk ka pasur mundësi që të zbatohet algoritmi i njëjtë për shpërndarjen automatike, si në prokuroritë tjera themelore. KPK-ja ka bërë kërkesën te OE-ja që të bëhet ndryshimi i algoritmit për t'iu përshtatur këtij njësi. Ndërsa, sa i përket Prokurorisë Speciale, KPK-ja ka formuar 4 departamente të reja<sup>27</sup>, të cilat nuk kanë qenë më parë dhe kërkesa për zhvillim është paraqitur te OE.</p>	Shtetit, me aplikimin e SMIL-it;		Të bashkëngjitur gjemi draftin e parë të Rregullores si dhe planin e raportit të avancuar në SMIL.	
4	KPK-ja nuk ka zyrtar për sigurinë e informacionit dhe në strukturën organizative të	Struktura e sigurisë së TI-së. KGJK-ja dhe KPK-ja të sigurangazhojnë zyrtarë për sigurinë e informacionit në	KPK	Vazhdimisht është bërë kërkesë Qeverisë për lejimin e pozitës: Administrator i Lartë	Mars, 2022

	<p>Departamentit të TI-së të Sekretariatit të KPK-së ende nuk është miratuar dhe përcaktuar pozita "Specialist i sigurisë". Gjithashtu, nuk është angazhuar një zyrtar për kryerjen e kësaj detyre.</p>	<p>secilën nga këto dy institucione që të mundësojnë operim të sigurt të pajisjeve përpunuese</p>		<p>për sigurisë, mirëpo deri më tani nuk është lejuar.</p> <p>Po ashtu kërkesa është përsëritur prapë në rishikimin e buxhetit për vitin 2021. Ne si departament kemi ndërmarrë hapat e nevojshëm që ta adresojmë me kohë kërkesën e tillë, por ende nuk kemi konfirmim nga Qeveria për përmbushjen e kërkesës sonë, përkundër që kërkesa përsëritet vazhdimisht.</p> <p><i>Të bashkangjitur gjeni kërkesën e dërguar në Qeverie për lejimin e pozitave.</i></p>	
5	<p>Në KPK nuk është realizuar mundësia për enkriptimin e të dhënave që vendosen në SMIL. KPK-ja kishte objektivë në planin strategjik të TI-së enkriptimin e të dhënave. Enkriptimi nuk është vendosur si prioritet që të zhvillohet menjëherë në SMIL, por mendohet të realizohet në një fazë të mëvonshme kur do të fillohet me largimin e proceseve të bazuara në kopje fizike. Në infrastrukturën e rrjetit të gjitha të dhënat</p>	<p>Enkriptimi i të dhënave në SMIL. KPK-ja duhet të realizoj mundësinë e enkriptimit të të dhënave në sistemin "SMIL" që të mundësojë vendosjen e masave të fshehta në sistem, gjë që e ka të paraparë edhe me strategjinë e TI-së dhe kërkesat e sistemit.</p>	<p><b>Projekti TIK/SMIL</b></p>	<p>Ky aktivitet është planifikuar të përfundohet në fazën konsoliduese të Projektit TIK/SMIL.</p> <p>Aktivitet ka përfunduar përkatësisht është zhvilluar pjesa e enkriptimit të të dhënave në SMIL.</p> <p><i>Të bashkangjitur gjeni një mostër të enkriptimit të të dhënave.</i></p>	<p>Ky aktivitet është zbatuar</p>

	enkrptohen duke përdorur IPSec, të dhënat janë të administruara në pajtim me protokollet e Microsoftit për qasje në folder.				
6	Në Qendrën e të Dhënave të përbashkët për KGJK-në dhe KPK-në ishin të autorizuar për qasje më shumë se nga një person (zyrtarë të TI-së) për të dy institucionet. Kjo kishte ndodhur në mungesë të procedurës së veçantë për qasje në qendrën e të dhënave dhe duke iu mundësuar qasje këtyre zyrtarëve pa pasur rolin për administrimin e qendrës së të dhënave.	Qasja fizike për sigurimin e pajisjeve të TI-së. KGJK-ja dhe KPK-ja të hartojnë, miratojnë dhe të zbatojnë procedurën për qasje në Qendrën e të Dhënave	KPK  KGJK	Aktualisht procedurat për siguri të qendrës së të dhënave janë të përfshira në kuadër të dokumenteve tjera të aprovuara në zbatim, mirëpo plani është të avancohen në procedura të veçanta vetëm për qendrën e të dhënave.  KGJK dhe KPK do të përgatisin procedurat e përbashkëta për qasjen fizike në qendrën e të dhënave.  Aktivitetet kryesore:  1. Përgatitja e draftit të procedurave tremujori i parë 2022 dhe 2. Aprovimi i tyre në KGJK dhe KPK, tremujori i dytë 2022.	Janar – Qershor, 2022
7	KGJK-ja dhe KPK-ja nuk përdorin plotësisht sistemet për menaxhimin e incidenteve për	Menaxhimi i incidenteve dhe problemeve. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të marrin vendim që obligon të gjithë	KPK	Në vazhdimësi jemi duke bërë përpjekje për zbatimin e plotë të sistemit të HelpDesk-ut. Progresi i përdorimit të	Mars, 2022

	<p>regjistrimin e incidenteve/gabimeve që ndodhin në infrastrukturën e TI-së, duke qenë se këto sisteme janë vënë në përdorim në të njëjtën kohë me sistemin SMIL, i cili ka pasur prioritet të zbatimit. KGJK-ja ka dy sisteme për menaxhimin e incidenteve JIRA dhe SYS AID, ndërsa KPK ka sistemin JIRA dhe InvGate. Këto sisteme, për momentin, përdoren vetëm nga zyrtarët e TI-së dhe departamenti i TI-së, por nuk përdoren plotësisht nga përdoruesit e fundit (gjyqtarë/prokurorë dhe zyrtarët administrativ), të cilët problemet i lajmërojnë në forma të tjera si telefon, email, etj.</p>	<p>përdoruesit e sistemeve të informacionit të përdorin sistemet për menaxhimin e incidenteve dhe asnjë kërkesë të mos trajtohet në asnjë hap jashtë këtyre sistemeve;</p>		<p>sistemit vazhdimisht është duke u rritur. Gjatë muajit Korrik - Tetor është planifikuar ri-trajnimi i stafit në përdorim të sistemit helpDesk. Gjatë muajve Nëntor '21 - Mars'22 do të bëhet asistim te stafi sipas kërkesës që mund të paraqitet.</p>	
8	<p>KGJK-ja dhe KPK-ja nuk kanë ndërprerë qasjen në SMIL për një numër përdoruesish të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Po ashtu, nuk iu kanë ndryshuar rolet në SMIL</p>	<p>Qasja logjike. KGJK-ja dhe KPK-ja të pasivizojnë llogarinë e përdoruesit menjëherë pas njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe të bëjnë ndryshimin e rolit për ata që kanë ndryshuar pozitën e</p>	<p>Departamenti i TI  Departamenti për Burime Njerezore,</p>	<p>Divizioni i Burimeve Njerezore vazhdimisht bënë njoftimin për pasivizimin e llogarisë së përdoruese.</p>	<p>Ky aktivitet është zbatuar</p>



	<p>përdoruesve të cilët kanë ndryshuar marrëdhënien e punës. Sipas zyrtarëve të KGJK-së dhe KPK-së, kjo kishte ndodhur se disa përdorues (gjyqtarë/prokurorë) për të cilët figurojnë llogaritë aktive janë të ngarkuara me detyra (lëndë) të pazgjydhura dhe është kërkuar ricaktimi i atyre detyrave (lëndëve) të përdoruesit (gjyqtarët/prokurorët) e tjerë. Ndërsa, përdoruesit që nuk i kanë rolet e njëjta me ato në akt emërimi, arsyeja qëndron se këta përdorues janë të ngarkuar me detyra shtesë.</p>	<p>punës. Të realizojnë bartjen e lëndëve në SMIL. nëpërmjet llogarisë aktive të Kryetarit të Gjykatës/ Kryeprokurorit nga gjyqtari/prokurori që ka ndërprerë marrëdhënien e punës te gjyqtarët/prokurorët e tjerë, pa qenë e nevojshme mbajtja aktive e llogarisë, apo ri-aktivizimi i saj;</p>	<p><b>Prokurim dhe Administratë</b></p>	<p>Departamenti i TI, përkatësisht personi i caktuar në bashkëpunim me Divizionin e BNJ në baza mujore bënë kontrollin e përdorueseve të sistemit prokurorial.</p>	
10	<p>Nuk kanë procedurë për rishikimin e të drejtave të qasjes së përdoruesve në baza kohore të caktuara, prandaj, kemi hasur edhe në llogari aktive të përdoruesve që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës.</p>	<p><b>Menaxhimi i privilegjeve të përdoruesve për sigurimin e informacionit.</b> KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të krijojnë procedurën për rishikimin e privilegjeve të përdoruesve në baza kohore. Të pasivizojnë llogaritë e personave që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës. Të sigurojnë mekanizmat për</p>	<p><b>Departamenti i TI</b></p> <p><b>Departamenti për Burime Njerezore, Prokurim dhe Administratë</b></p>	<p>Privilegjet e përdorueseve përcaktohen në bazë të Rregullores së TIK përkatësisht të shtojcës 1.</p> <p>Është caktuar personi i cili në baza mujore bënë kontrollin e privilegjeve të përdorueseve.</p>	<p><b>Ky aktivitet është zbatuar</b></p>

		monitorimin e gjurmueshmërisë të aktiviteteve të përdoruesve në sistemet e informacionit.			
11	<p>KGJK-ja dhe KPK-ja nuk kanë qendër të rimëkëmbjes dhe plan të vazhdimësisë së punës së sistemeve të informacionit, për rimëkëmbjen në rast të fatkeqësive për qendrën e të dhënave primare (DRP), i cili do t'i mundësonte vazhdimësinë e shërbimeve kritike dhe proceseve të punës në rast të një ndërprerje. Mirëpo, kanë realizuar kopje rezervë të sistemeve dhe bazës së të dhënave, së bashku me infrastrukturën kritike duke krijuar redundancë të serverëve dhe infrastrukturës së rrjetit. KPK-ja një herë në muaj sipas planit/procedurave të saj bën testimin e kopjeve rezervë për rikthimin e tyre dhe krijon raporte të</p>	<p>Plani dhe politikat për vazhdimësinë e biznesit. KGJK-ja dhe KPK-ja të hartojnë, miratojnë dhe të zbatojnë planin e rimëkëmbjes në rast të fatkeqësive për qendrën e të dhënave i cili do t'i mundësonte vazhdimësinë e shërbimeve kritike në rast të një ndërprerje të aktiviteteve.</p>	KPK	<p>Është përgatitur Projekti për ndërtimin e Qendrës së Rimëkëmbjes në PTH Gjakovë. Për shkak të kostos së lartë ky projekt është dorëzuar për financim në projektin e MCC dhe të EukoJust.</p> <p>Jemi në pritje se cili projekt do ta mbështesë financiarisht ndërtimin e qendrës.</p> <p>Hapësira është ndarë në PTH Gjakovë, gjithsejtë 40 m<sup>2</sup>.</p>	Qershor – Dhjetor, 2022

<p>testimit, ndërsa KGJK-ja nuk ka bërë teste për kopjet rezervë. Po ashtu, KPK-ja duke marrë parasysh rëndësinë e sistemit të informacionit për menaxhimin e lëndëve për prokurorët dhe stafin mbështetës, ka paraparë në planin strategjik të TIK-ut nevojën për krijimin e planit të rimëkëmbjes dhe gjithashtu, ka filluar ndërtimin e një qendre të rimëkëmbjes. Kjo qendër planifikohet që të realizohet nga programi për financim Korporata Sfidat e Mileniumit (MCC) që të blihet "storage". Ndërsa në KGJK, për shkak të financimeve të vazhdueshme që bëhen në sistemet primare, qendrën për rimëkëmbje planifikojnë ta shfrytëzojnë të gatshme nga një institucion tjetër shtetëror</p>				
--	--	--	--	--

